

Partia e Drejtësisë

Statuti

Kuvendi i Punës i PD-së i mbajtur më 22/09/2019 miratoi:

Statuti i Partisë së Drejtësisë

Kapitulli I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Partia e Drejtësisë (në tekstin e mëtejshëm, PD) është parti politike demokratike, parimet, qëllimi, organizimi dhe aktivitetet e së cilës janë të përcaktuara me Program dhe Statut.

Neni 2

1. Selia e PD-së është në Prishtinë.
2. Vula e PD-së ka formën e rrumbullakët dhe përmban logon dhe tekstin; Partia e Drejtësisë.
3. Vula e PD-së nuk mund të përdoret veçse në dokumente e shkresa që mbajnë nënshkrimin e kryetarit, të nënkryetarëve dhe sekretarit të përgjithshëm të PD-së.
4. PD ka emblemën, përmbajtjen e së cilës e përcakton Këshilli Drejtues i PD-së, me vendim të posaçëm.

Neni 3

1. Njësi themelore organizative e PD-së është dega.
2. Degët e PD-së kanë vulë të rrumbullakët, që përmban: logon dhe tekstin: Partia e Drejtësisë – Dega në (qyteti përkatës).
3. Vula e degëve të PD-së mund të përdoret vetëm krahas nënshkrimit të Kryetarit të degës, Nënkyetarit të degës ose Sekretarit të degës.

Neni 4

1. Strukturat përbërëse funksionale të PD-së janë Vizioni i gruas dhe Vizioni i rinisë.

2. Vizioni i Rinisë dhe Vizioni i Gruas janë struktura funksionale të PD-së në nivelin qendror dhe lokal, që veprojnë në bazë të Rregulloreve të punës, të miratuara nga Këshilli Drejtues i PD-së.

Neni 5

PD-ja mund të zhvillojë marrëdhënie të ngushta me shoqatat dhe klubet e bashkatdhetarëve në mërgatë, të cilat mbështesin Programin e PD-së.

Neni 6

PD-në, si person juridik, mund ta përfaqësojnë: Kryetari, nënkryetarët, Sekretari i përgjithshëm, dhe personi i autorizuar nga Kryetari i PD-së.

Kapitulli II

Anëtarësimi dhe anëtarësia në PD

Neni 7

1. Anëtar i PD-së mund të bëhet çdo qytetar me të drejtë vote dhe aftësi veprimi, i cili pranon Programin dhe Statutin e PD-së.
2. Anëtarësimi bëhet nëpërmjet shprehjes së lirë të vullnetit dhe nënshkrimit të fletë anëtarësimi.

Neni 8

1. Fletë anëtarësimet merren në degët e PD-së.
2. Evidenca e anëtarësisë në degë është bazë për formimin e evidencës unike në PD.
3. Regjistri qendror i anëtarëve të PD-së udhëhiqet nga shërbimi administrativ.
4. Anëtarëve të PD-së u jepet librezë e anëtarësisë.
5. Pamjen dhe përmbajtjen e librezës së anëtarësisë e përcakton Këshilli Drejtues i PD-së.

Neni 9

1. Nuk mund të jenë apo të bëhen anëtarë të PD-së personat, që janë:
 - 1.1. anëtarë të ndonjë partie tjetër;
 - 1.2. punonjës të institucioneve që u ndalohet me ligj anëtarësimi në parti politike;
 - 1.3. të njohur për veprimtari antikombëtare, amorale dhe antisociale.

Neni 10

1. Fletë anëtarësimet shqyrtohen e miratohen në degën përkatëse të PD-së.

Neni 11

Librezë e anëtarësimi në PD lëshohet nga kryesia e degës.

Neni 12

1. Anëtari ka të drejtë të largohet nga PD-ja në çdo kohë, pa dhënë shpjegim.
2. Në këtë rast ai e ka për obligim moral ta dorëzojë librezën e anëtarësisë në kryesinë e degës.
3. Anëtari i larguar çregjistrohet nga të gjitha regjistrat e anëtarësisë.
4. Ri pranimi nuk mund të bëhet pa miratimin e Këshillit Drejtues të PD-së, në bazë të propozimit të Gjykatës së Nderit.

Neni 13

Anëtari i PD-së mund të kalojë nga një degë në tjetrën, kur ndërron vendbanimin ose për arsye që i çmon kryesia e degës, nëpërmjet çregjistrimeve dhe regjistrimeve përkatëse partiake.

Neni 14

1. Anëtarësia në PD ndërpritet në rastet, si vijon:
 - 1.1. tërheqja me kërkesë personale;
 - 1.2. përjashtimi nga PD-ja dhe
 - 1.3. vdekja.

Neni 15

1. Anëtari mund të përjashtohet nga PD-ja, në rastet kur:
 - 1.1. shkel me dashje programin ose statutin dhe/ose cenon interesat e PD-së;
 - 1.2. vërtetohet se ka mashtruar për të fshehur rrethanat që e pengonin të ishte anëtar i PD-së, sipas dispozitave të këtij Statuti;
 - 1.3. kryen vepra penale ose veprime që e dëmtojnë rëndë punën dhe imazhin e PD-së.

Neni 16

1. Vendimin për përjashtimin nga PD-ja e nxjerr kryesia e degës.
2. Para nxjerrjes së vendimit, anëtarit të PD-së, kundër të cilit zhvillohet procedura, duhet t'i mundësohet që t'i arsyetojë qëndrimet e veta dhe të japë provat e nevojshme.
3. Procedurën për përjashtim mund ta iniciojë edhe Kryesia e PD-së.
4. **Kundër vendimit për përjashtim mund të kryhet ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, para Gjykatës së nderit të PD-së.**
5. Vendimi i Gjykatës së nderit është përfundimtar.

Kapitulli III

Të drejtat dhe detyrat e anëtarit

Neni 17

1. Të drejtat e anëtarit të PD-së janë:
 - 1.1. të marrë pjesë dhe të vendosë për të gjitha çështjet me rëndësi për PD-në, drejtpërsëdrejti

apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur.

- 1.2. të zgjedhë apo të zgjidhet në organet e PD-së,
- 1.3. të informohet mbi gjendjen dhe aktivitetet e PD-së dhe organeve të saj.
- 1.4. të parashtrojë iniciativa dhe propozime përkitazi me punën e PD-së dhe çështjet aktuale shoqërore të cilat kërkojnë angazhimin e PD-së.

Neni 18

1. Detyrat e anëtarit të PD-së janë:

- 1.1. të veprojë në harmoni me programin, statutin dhe aktet e tjera normative të PD-së;
- 1.2. të angazhohet në mënyrë aktive për realizimin e qëllimeve politike të PD-së;
- 1.3. t'i përfaqësojë në mënyrë dinjitoze përcaktimet programore dhe qëndrimet e organeve partiake në institucionet e sistemit politik dhe shtetëror;
- 1.4. të paguajë anëtarësinë;
- 1.5. të zbatojë vendimet e organeve partiake;
- 1.6. të ruajë dhe të ngrejë prestigjin e PD-së.

Neni 19

1. Këshilli Drejtues në propozim të Kryesisë së Partisë nxjerr Kodin Etik të Partisë.
2. Anëtarët e PD-së janë të obliguar të respektojnë në përpikëri Kodin Etik.
3. Masat disiplinore për shkeljen e Kodit Etik përcaktohen në vetë Kodin Etik.

Neni 20

Këshilli Drejtues në propozim të Kryetarit, vendos për dhënien e titullit të nderit “Anëtar Nderi i PD-së” për personalitetet me kontribut të veçantë kombëtar apo partiak pas dhënies së pëlqimit nga ana e tij.

Kapitulli i IV

Organizimi i brendshëm

Neni 21

PD organizohet në baza territoriale në: nëndegë, degë dhe në organe qendrore.

Neni 22

1. Nëndegët formohen në fshatra, komuna, lagje ose qytete.
2. Nëndegët formohen me 9 (Nëntë) ose më shumë anëtarë.
3. Formimin e nëndegëve e bën kryesia e degës.
4. Formimin e nëndegëve në komunat ku nuk ka degë e bën Këshilli nismëtar i degës.
5. Këshilli nismëtar i degës së paku pesë (5) anëtarë.
6. Këshilli nismëtar i degës duhet të miratohet nga Kryesia e Partisë.

7. Organi më i lartë i nëndegës së PD-së është Kryesia e nëndegës.
8. Mandati i Kryesisë së nëndegës është katër (4) vjet.
9. Kryesia e nëndegës mblidhet për të zgjedhur Kryetarin e nëndegës dhe kandidatët për Kuvendin e degës.
10. Kryesia e nëndegës mund të mblidhet edhe sipas nevojës ose me vendim të posaçëm të Kryesisë së degës.
11. Kryesia e nëndegës konsiderohet legjitime kur në të merr pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të Kryesisë.
12. Kryesia e nëndegës ka shtatë (7) anëtarë përfshirë kryetarin dhe 2 (dy) nënkryetar prej të cilëve një është për çështje rinore dhe një për çështje të gruas.
13. Kryesia e nëndegës mblidhet periodikisht sipas kushteve dhe rrethanave së paku 1 (një) herë në muaj.
14. Në mbledhjet e Kryesisë së nëndegës kanë të drejtë të marrin pjesë, pa të drejtë vote, anëtarët e Kryesisë së degës.
15. Mbledhjet e Kryesisë së nëndegës drejtohen nga kryetari, nënkryetari ose anëtari i Kryesisë i përcaktuar nga Kryetari.
16. Vendimet e mbledhjes janë të vlefshme kur për to voton shumica e thjeshtë e anëtarëve prezent të Kryesisë së nëndegës.
17. Në rast të votave të barabarta vota e Kryetarit të nëndegës ka vlerë të dyfishtë.
18. Në mbledhjen e Kryesisë së nëndegës në mënyrë të obligueshme duhet të merr pjesë sekretari i degës ose anëtari i Kryesisë së degës i autorizuar nga Kryetari ose Sekretari i degës.

Neni 23

1. Njësia kryesore organizative e PD-së është dega.
2. Dega organizohet në çdo komunë të Kosovës.
3. Miratimin përfundimtar të themelimit të degës e bën Këshilli Drejtues.

Neni 24

1. Organi më i lartë i degës është Kuvendi.
2. Kuvendi zgjedhor i degës mblidhet çdo 4 vite.
3. Kuvendi mblidhet çdo vit, në mbledhje të rregullt për shqyrtimin e punës njëvjeçare të degës.
4. Sipas nevojës mund të thirret edhe Kuvendi i jashtëzakonshëm, me vendim të Kryesisë së PD-së, ose Kryesisë së degës.
5. Numri i anëtarëve të Kuvendit të degës nuk mund të jetë më i vogël se pesëdhjetë anëtarë.
6. Me rastin e përcaktimit të listës së anëtarëve të Kuvendit të degës, çdo nëndegë duhet të sigurojë që 30% e anëtarëve të jenë femra.
7. Anëtarët e Kuvendit të degës duhet të jenë të deleguar nga Kryesia e nëndegës sipas numrit të anëtarëve të regjistruar në nëndegën përkatëse dhe çelësit të përcaktuar nga Kryesia e degës.
8. Kuvendi i degës mund ta fillojë pas vërtetimit të kuorumit që e paraqet shumica e thjeshtë e anëtarëve të Kuvendit, sipas paragrafit 5 të këtij neni.

9. Në fillim të mbledhjes duhet të aprovohet rendi i ditës me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, me mandat të verifikuar.
10. Vendimet e Kuvendit të degës janë të vlefshme kur për to votojnë shumica e anëtarëve prezent.
11. Puna e Kuvendit të degës përcaktohet me këtë Statut dhe Rregulloren e punës, të miratuar nga Këshilli Drejtues në propozim të Kryesisë së Partisë.

Neni 25

1. Veprimtarinë e degës midis dy Kuvendeve e drejton Kryetari dhe Kryesia me mandat katërvjeçar.
2. Kryesia e degës përbëhet prej më së shumti 13 (trembëdhjetë) anëtarëve, 4 (katër) prej tyre duhet të jenë femra, minimumi i numrit të anëtarëve të kryesisë së degës duhet të jetë 9 (nëntë anëtarë) ku prej tyre 3 (tri) femra.
3. Kryesia e degës zgjedh nga radhët e veta me propozim të Kryetarit të degës: 3 (tre) nënkryetarë;
 - a) për çështje organizative (1)
 - b) për çështje rinore (1) dhe
 - c) për çështje të Gruas (1).
4. Kryesia e degës me propozim të Kryetarit të degës, zgjedhë Sekretarin e degës.
5. Kryesia e degës ka të drejtë që të kooptojë në radhët e saja 2 (dy) anëtarë të tjerë, në pajtim me interesat e partisë, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.
6. Kryetarin dhe Kryesinë e degës e zgjedhë Kuvendi i degës me shumicën e thjeshtë të votave.
7. Anëtarë të Kryesisë së degës sipas funksionit janë kryetarët e nëndegëve.
8. Kryesia drejtohet nga Kryetari i Degës e në mungesë të tij nga Nënkryetari apo kryesuesi i propozuar nga Kryetari.
9. Kryesia e degës mban mbledhje së paku një (1) herë në muaj.
10. Mbledhja e Kryesisë së degës ftohet nga Kryetari i degës, ose me 2/3 e nënshkrimeve të anëtarëve të kryesisë së degës ose nga Kryesia e Partisë.
11. Vendimet e mbledhjes janë të vlefshme kur për to votojnë shumica e thjeshtë e numrit prezent të anëtarëve të Kryesisë së degës.
12. Në rast të votave të barabarta, vota e Kryetarit të degës ka vlerë të dyfishtë.
13. Në këto mbledhje mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, anëtarët e Kryesisë ose të Këshillit Drejtues të PD-së.
14. Puna e Kryesisë së Degës zbatohet në bazë të këtij Statuti dhe Rregullores së punës, të miratuar në Këshilli Drejtues me propozim të Kryesisë së Partisë.
15. Në mbledhjen e Kryesisë së degës në mënyrë të obligueshme duhet të merr pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Partisë ose anëtari i Kryesisë së Partisë i autorizuar nga Kryetari ose Sekretari i Partisë.

Neni 26

Organet qendrore të PD-së

1. Organet qendrore të PD-së janë :
 - 1.1. Kuvendi;

- 1.2. Kryetari;
- 1.3. Këshilli Drejtues;
- 1.4. Kryesia e Këshillit Drejtues (në tekstin e mëtejme, Kryesia e PD-së);

2. Përgjegjës për deklarata zyrtare është Zëdhënësi i PD-së, i zgjedhur nga Kryesia e PD- së.

Neni 27

Kuvendi i PD-së

1. Organi më i lartë i PD-së është Kuvendi.
2. Kuvendi mbledhet çdo vit, në mbledhje të rregullt për shqyrtimin e veprimtarisë së punës njëvjeçare.
3. Çdo 4 vite mbledhet Kuvendi zgjedhor.
4. Sipas nevojës mund të thirren edhe Kuvende të jashtëzakonshme, me vendim të Këshillit Drejtues, në propozim të Kryesisë së PD-së.
5. Numri i anëtarëve të Kuvendit përcaktohet, sipas përpjesëtimit të mbështetur në përqindjen e votave në zgjedhjet lokale sipas degëve.
6. Çdo degë duhet të sigurojë që në listën e anëtarëve të Kuvendit, 30% të jenë femra nga numri i gjithëmbarshtëm i anëtarëve.
7. Kryetari dhe Kryesia janë anëtar të Kuvendit, sipas pozitës.
8. Kuvendi mund ta fillojë mbledhjen pas vërtetimit të kuorumit që e paraqet shumica e thjeshtë e anëtarëve, sipas paragrafit 5 të këtij neni.
9. Në fillim të mbledhjes duhet të aprovohet rendi i ditës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
10. Vendimet e Kuvendit janë të vlefshme kur për to votojnë shumica e anëtarëve prezent.

Neni 28

1. Kuvendi:
 - 1.1. aprovon Programin;
 - 1.2. aprovon Statutin;
 - 1.3. shqyrton dhe vlerëson punën e PD-së dhe organeve të saj (raportin mbi punën e: Kryesisë, Këshillit Drejtues, Gjykatës së nderit, Komisionit mbikëqyrës të Statutit dhe Komisionit të kontrollit financiar), si dhe merr vendime përkatëse.
 - 1.4. zgjedh Kryetarin e PD-së;
 - 1.5. zgjedh Këshillin Drejtues;
2. Programi dhe Statuti i PD-së, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre, bëhen me aprovimin e 2/3 të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.

Neni 29

Veprimtaria e PD-së, në periudhën midis dy Kuvendeve, drejtohet nga Kryetari, Këshilli Drejtues, dhe Kryesia e PD-së.

Neni 30

Kryetari i PD-së

1. Kryetari udhëheq dhe përfaqëson PD-në, në pajtim me programin dhe statutin.
2. Kryetari zgjidhet nga Kuvendi.
3. Mandati i Kryetarit është katër (4) vjet.
4. Për Kryetar mund të kandidojë çdo anëtar i PD-së i cili ka mbi 35 vjet dhe ka mundësi rizgjedhjeje deri në tre (3) mandate të njëpasnjëshme. Nga miratimi i këtij statuti
5. Kandidatura me shkrim, programi zgjedhor dhe lista me nënshkrimet e së paku 1/3 së anëtarëve të Kuvendit Zgjedhor (me të cilën përkrahet kandidatura për Kryetar), duhet të dorëzohet në Kryesisë së Partisë së paku një (1) muaj para mbajtjes së Kuvendit zgjedhor.
6. Kryetari aktual duhet të parashtrojë në Këshillin Drejtues kandidaturën me shkrim dhe programin zgjedhor.
7. Në situatën kur ka më shumë se një kandidat, votimi për Kryetar është i fshehtë.
8. Nëse ekziston vetëm një kandidat votohet sipas përcaktimit të Kuvendit.

Neni 31

Këshilli Drejtues i PD-së

1. Këshillin Drejtues e zgjedh Kuvendi në propozim të Kryetarit ose anëtarëve të kuvendit.
2. Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës në periudhën midis dy Kuvendeve.
3. Këshilli Drejtues nuk mundë të tejkaloi 1/2 e numrit të anëtarëve të Kuvendit, por jo më pak se 35.
4. Anëtarë të Këshillit Drejtues, sipas funksionit janë edhe kryetarët e degëve, si numër shtesë i numrit nga paragrafi 3 i këtij neni.
5. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen nga Kuvendi, duke siguruar përfaqësimin përpjesëtimor të degëve në Kosovë, përfshirë sigurimin e strukturës përkatëse gjinore.
6. Çdo ndryshim i Kryesisë së PD-së dhe Kryetarëve të degëve pasqyrohet në përbërjen e Këshillit Drejtues.
7. Këshilli Drejtues, në mbledhjen e parë zgjedh nga radhët e veta Kryesin e PD-së, në propozim të Kryetarit ose të anëtarëve të këshillit drejtues duke u votuar më pasë nga anëtarët e KD-së.
8. Këshilli Drejtues ka të drejtë të bëjë zëvendësimin e anëtarëve të tij që vijnë nga degët, në propozim të Kryesisë së degës, pas miratimit nga Kryesia e PD-së.
9. Mbledhja mund të fillojë pas vërtetimit të kuorumit që e përbën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të Këshillit Drejtues.
10. Vendimet janë të vlefshme kur për to ka votuar shumica e thjeshtë e numrit të anëtarëve prezent.
11. Punimet e Këshillit Drejtues drejtohen nga Kryetari, ose anëtari i Kryesisë së PD-së i caktuar nga Kryetari.
12. Me rastin e votimit në Këshillin Drejtues, në rastin e votave të barabarta, vota e Kryetarit ka

vlerë të dyfishtë.

13. Këshilli mblidhet së paku dy (2) herë në vit; puna e tij zbatohet në bazë të rregullores së punës të miratuar nga Këshilli Drejtues, **në propozim të Kryesisë së Partisë.**

14. Zgjedh Komisionin Mbikëqyrës të Statutit, dhe komisionin e kontrollit financiar,

15. Zgjedh Gjykatën e Nderit.

Neni 32

Kryesia e PD-së

1. Kryesia e PD-së përbëhet prej 35 (Tridhjetë e pesë) anëtarëve ose më pak , prej tyre 30% anëtarë femra.
2. Kryesia e PD-së zgjedhë nga radhët e saj Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë dhe 3 nënkryetarë në propozim të Kryetarit.
3. Kryesia e PD-së ka të drejtë që të kooptojë në radhët e saja edhe anëtarë të tjerë, por duke mos e kaluar numrin e paraparë nga paragrafi 1 i këtijë neni.
4. Kryesia e PD-së drejtohet nga Kryetari e në mungesë të tij nga kryesuesi i propozuar nga Kryetari apo Kryesia.
5. Kryesia bën mbledhje të rregullta, jo me rrallë se një (1) herë në muaj.
6. Vendimet e mbledhjes janë të vlefshme kur për to votojnë shumica e thjeshtë e numrit prezent të anëtarëve të Kryesisë.
7. Mbledhja e Kryesisë ftohet nga Kryetari i Partisë ose nga 2/3 e Kryesisë së PD-së.
8. Në rast të votave të barabarta vota e Kryetarit ka vlerë të dyfishtë.
9. Mbledhja e Kryesisë së PD-së mund të fillojë pas vërtetimit të prezencës së gjysmës së anëtarëve të Kryesisë.
10. Kryesia e PD-së udhëheq punën midis dy mbledhjeve të Këshillit Drejtues dhe raporton për punën e bërë.
11. Ajo vepron si organ kolegjal në përcaktimin e qëndrimeve dhe marrjen e vendimeve dhe kujdeset për funksionimin unik të PD-së, në bazë të Programit dhe Statutit.
12. Kryesia e PD-së kërkon nga degët informacione të rregullta, me fillim të çdo muaji.
13. Kryesia e PD-së zbaton punën e saj në pajtim me rregulloren e veçantë të punës të miratuar nga Këshilli Drejtues.
14. Përveç rasteve të përcaktuara me nenin 14 të këtij STATUTI, mandati i anëtarit të Kryesisë së PD-së ndëshkohet me automatizëm nëse anëtari i PD-së ka më shumë se 3 (tri) mungesa të paarsyetuara në mbledhjet e Kryesisë gjatë një viti.
15. Për arsyeshmërin e mungesave vendos Kryesia e Partisë.

Neni 33

Nënkryetarët e PD-së

1. Nënkryetarët e PD-së, i përgjigjen Kryetarit të PD-së dhe zgjidhen nga Kryesia e PD-së në propozim të Kryetarit. PD ka tre (3) nënkryetar.

2. Nënkyetarët janë përfaqësues politik dhe funksional të PD-së.

a) Një (1) nënkryetarë zgjidhet për çështje politike;

b) Dy (2) nënkryetarë njëri për çështjen e gruas, i cili në të njëjtën kohë udhëheq edhe Vizionin e Gruas, dhe njëri për çështje rinore, i cili udhëheq Vizionin Rinor.

Neni 34

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i përgjigjet Kryetarit të PD-së dhe zgjidhet nga Kryesia e PD- së, në propozim të Kryetarit të PD-së.

2. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për;

1.1. Koordinimin dhe funksionimin e degëve të PD-së;

1.2. Organizimin dhe mbikëqyrjen e punës së administratës qendrore të PD-së;

1.3. Mbajtjen e mbledhjeve të rregullta çdo tre muaj me sekretarët e degëve, drejtorët e drejtorateve dhe asamblastët e PD-së.

1.4. Kujdesjen dhe mbikëqyrjen e gjendjes financiare të PD-së;

1.5. Organizimin e mbledhjeve të Kryesisë, Këshillit Drejtues dhe Kuvendit të PD-së.

1.6. Informimin e Këshillit Drejtues dhe Kuvendit për veprimtarinë administrative, financiare dhe organizative të PD-së;

1.7. Detyra të tjera të caktuara nga Kryesia dhe Kryetari i PD-së.

3. Sekretari i përgjithshëm i PD-së, përgatit raporte për Kryesinë e PD-së çdo gjashtë muaj, ose me shpesh sipas kërkesës së Kryesisë si dhe Kryetarit të PD-së.

4. Të drejtat dhe detyrimet e tjera specifike për sekretarin e përgjithshëm përcaktohen me akte të përgjithshme të Kryesisë.

Neni 35

Vizioni i gruas dhe Vizioni rinor

1. Vizioni i gruas dhe Vizioni rinor udhëhiqen nga nënkryetarët e PD-së për çështje të gruas dhe për çështje rinore, të zgjedhur nga Kryesia e PD-së në propozim të Kryetarit.

2. Funksionimi dhe organizimi i Vizionit të Gruas dhe Vizionit Rinor rregullohet me rregullore të veçantë që e miratohet nga Këshilli Drejtues i PD-së.

Neni 36

Administrata qendrore e PD-së

1. Administrata qendrore e PD-së, organizohet me qëllim të funksionalizimit dhe organizimit sa më të mirë të punës politike të Kryesisë së PD-së, degëve dhe Këshillit Drejtues të PD-së.

2. Administrata e PD-së është e obliguar që të kryej detyrat e saj në funksion të promovimit të punës së Kryesisë së PD-së.
3. Punëtorët e administratës zgjedhën nga Komisioni vlerësues i cili përzgjidhet nga anëtarët e Kryesisë së PD-së, në propozim të Sekretarit të Përgjithshëm.
4. Pagat dhe benificionet e tjera për anëtarët e administratës caktohen me vendim të Kryesisë së PD-së, në propozim të Sekretarit të Përgjithshëm.
5. Administrata qendrore e PD-së i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm.
6. Organizimi dhe funksionimi i administratës qendrore të PD-së, rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Kryesia e PD-së.

Neni 37

Komisioni për Kuadrot e PD-së

1. Në kuadër të Kryesisë së PD-së funksionon Komisioni për kuadro, që ka për qëllim udhëheqjen e politikës kadrovike brenda PD-së.
2. Komisioni, udhëhiqet nga Kryetari i PD-së dhe ka në përbërjen e tij nënkryetarët e PD-së, sekretarin dhe dy anëtarë të Kryesisë që i zgjedhë Kryesia e PD-së.
3. Kompetencat e Komisionit janë propozimi për Kryesinë e PD-së të kandidatëve për:
 - 3.1. deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
 - 3.3. kryetar të komunave,
 - 3.4. funksione të tjera shtetërore, publike.
 - 3.5. propozimin e kabinetit të ministrave, zv ministrave etj,

Neni 38

Komisioni për mbikëqyrje dhe zbatim të Statutit

1. Komisioni për Mbikëqyrje dhe zbatim të Statutit përbëhet prej tre (3) anëtarëve.
2. Detyra e Komisionit është evidentimi i shkeljeve të Statutit; formulimi i raporteve me vërejtje dhe rekomandime për Këshillin Drejtues dhe Kryesinë e PD-së, si dhe paraqitja e raportit në Kuvend.
3. Komisioni zgjedh kryetarin nga radhët e tij.
4. Detyrat dhe kompetencat e Komisionit rregullohen me rregullore të veçantë, të cilën e miraton Kryesia e Partisë.

Neni 39

Gjykata e nderit

1. Gjykata e Nderit zgjidh ankesat që janë parashtruar në vendimet mbi shqiptimin e masave disiplinore ndaj anëtarëve të PD-së dhe organeve të saj, si dhe rastet e tjera që janë përcaktuar me

Statut dhe aktet e tjera të përgjithshme të PD-së.

2. Gjykata përbëhet prej pesë (5) anëtarëve: Kryetarit, dhe katër (4) anëtarëve të tjerë.

3. Në procedurën para Gjykatës së nderit, zbatohen dispozitat e akteve të përgjithshme të cilat rregullojnë vërtetimin e përgjegjësive.

Neni 40

Komisioni për Mbikëqyrje të veprimtarisë financiare

1. Kuvendi zgjedh Komisionin për Mbikëqyrje të Veprimtarisë Financiare, të përbërë prej tre (3) anëtarëve.

2. Për shkeljet që vëren, Komisioni informon Kryesinë e PD-së dhe Këshillin Drejtues, duke propozuar masa për rregullimin e gjendjes.

3. Kryesia e PD-së është e detyruar që t'i shqyrtojë raportet e Komisionit, të marrë masa dhe, përkitazi me to, të raportojë në Këshillin Drejtues.

Neni 41

1. Pranë Kryesisë së PD-së mund të formohen grupe pune dhe komisione të përhershme ose ad hoc për çështje të caktuara.

2. Këto grupe punuese përgatisin materiale pune që shërbejnë për analiza e vendime nga Këshilli Drejtues dhe Kryesia e tij.

3. Grupe pune mund të formojnë edhe kryesitë e degëve.

Kapitulli V

Funksionimi i brendshëm

Neni 42

1. PD-ja i shton radhët e veta dhe i forcon strukturat e saja partiake mbi bazën e vullnetit të lirë të anëtarëve të saj, mbështetur në të drejtën për zgjedhje dhe votim të lirë.

2. Çdo anëtar ose përfaqësues i deleguar në një forum nga një strukturë organizative e partisë ka një votë dhe të gjitha votat janë të barasvlershme.

Neni 43

1. Kandidatura për Kryetar të PD-së rregullohet në pajtim me këtë Statut.

2. Kandidaturat për kryetarin e nëndegës dhe kryetarin e degës mund të paraqiten si vijon:

2.1. Një kandidat nga kryesitë përkatëse, të nëndegës ose të degës;

2.2. Kandidaturën mund ta paraqesë çdo anëtar i PD-së që siguron, së paku një (1) muaj para Kuvendit përkatës, mbështetjen e 1/3 së anëtarëve të Kryesisë të nëndegës, apo të 1/3 së anëtarëve të Kuvendit të degës;

2.3. Kryetarët e mëparshëm, në të dy nivelet, kanë të drejtën e rizgjedhjes në tre mandate të njëpasnjëshme.

Neni 44

Kandidaturat për Kryesi të nëndegës propozohen në mbledhjen e Kryesisë të nëndegës ose Këshillit nismëtarë të nëndegës.

Neni 45

Kandidaturat për Kryesi të degës propozohen në mbledhjen e Kuvendit të degës.

Neni 46

Për çdo kandidaturë mund të ketë më shumë se një (1) kandidat të propozuar.

Neni 47

1. Çdo degë mund t'i propozojë Kryesisë së PD-së të përfshijë në listën e kandidatëve për deputet në Kuvendin e Kosovës nga dega përkatëse kandidatët meritator.
2. Kryesia e PD-së e përpilon listën e kandidatëve për deputet në propozim të Komisionit për kuadro dhe ia paraqet Këshillit Drejtues.
3. Për kandidaturat vendos Këshilli Drejtues me 1/2 e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 48

1. Kandidaturat për këshilltar në Asamblenë komunale dhe për Kryetar komune përcaktohen nga Kryesia e degës në konsultim me Kryesinë e PD-së.
2. Kryetari i degës në të njëjtën kohë është edhe bartës i listës si kandidat për këshilltar në asamblenë komunale dhe kandidatë për Kryetarë të Komunës.
3. Në raste të veçanta kryetari i degës, mund t'ia delegoj këtë të drejtë kandidatit tjetër, të cilin ja propozon Kryesisë së degës për miratim.
4. Kryetarët e nëndegëve, anëtarët e kryesisë së degës janë të obliguar që të jenë pjesë e listës zgjedhore, përveç nëse vendos ndryshe kryesia e degës.
5. Anëtarë të listës zgjedhore për këshilltar komunal janë edhe anëtarët e kryesisë qendrore sipas komunave prej të cilave kanë bazën deleguese, përveç nëse vendos ndryshe kryesia qendrore.

Neni 49

1. Në procesin e nxjerrjes së vendimeve nga organi përkatës, votimi bëhet me vota të hapura, nëse organi përkatës nuk vendos ndryshe.

Neni 50

1. Para se të fillojë votimi, në Kuvend dhe Këshilli Drejtues zgjidhet komisioni zgjedhor prej pesë (5) anëtarësh i cili ka për detyrë të bëjë verifikimin e delegatëve të pranishëm dhe të informojë për këtë organin përkatës.
2. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e Komisionit.
3. Komisioni merr në dorëzim, me procesverbal, fletëvotimet nga Kryesia e Kuvendit.
4. Fletëvotimet duhet të jenë të nënshkruara nga kryetari i komisionit dhe të vulosura.
5. Ato i jepen çdo delegati të organit zgjedhor në të gjitha nivelet, duke bërë shënimin në listën përkatëse.
6. Komisioni bën hapjen e kutisë së votimit dhe numërimin e votave në sallën e mbledhjes, ku mund të jenë të pranishëm edhe votuesit, pa e penguar punën e komisionit.
7. Komisioni mban procesverbalin mbi numërimin e votave dhe kryetari i komisionit komunikon rezultatin e zgjedhjeve.
8. Anëtarët e komisionit zgjedhor nuk mund të propozohen në listën e kandidatëve.
9. Komisioni i dorëzon dokumentet e votimit, me procesverbal, në kryesinë përkatëse të punës.
10. Dokumentet e votimit ruhen në arkivin e PD-së, deri në mbledhjen e ardhshme zgjedhore për të njëjtën çështje.

Neni 51

1. PD merr pjesë në zgjedhjet qendrore dhe lokale si subjekt i mëvetësishëm politik.
2. PD mund të bëjë koalicion parazgjedhor dhe pas zgjedhor në nivelin qendror dhe lokal.
3. Iniciativën për koalicion parazgjedhor në nivelin qendror e merr Kryesia e PD-së.
4. Iniciativën për koalicion parazgjedhor ose pas zgjedhor në nivelin lokal e merr Kryesia e degës.
5. Këshilli Drejtues vendos për miratimin apo refuzimin e iniciativës për koalicion parazgjedhor ose pas zgjedhor në nivelin qendror me 1/2 e votave, të anëtarëve të pranishëm në mbledhje..

Kapitulli VI

Respektimi i disiplinës

Neni 52

Demokracia e brendshme në PD realizohet brenda suazave të disiplinës së domosdoshme partiake.

Neni 53

Parimi themelor i disiplinës në PD është zbatimi me rreptësi i kërkesave të Programit, Statutit dhe Kodit Etik të Partisë, krahas respektimit të diversitetit dhe shprehjes së lirë të mendimit.

Neni 54

1. Mendimet e shprehura, të mbrojtura lirisht, mund të çojnë në kristalizimin e alternativave për mbështetjen e të cilave mund të veprojnë përkohësisht fraksione të ndryshme, që nuk kanë për qëllim përçarjen dhe shpërbërjen e PD-së, apo ndryshimin e themeleve ideore dhe organizative mbi të cilat ajo është krijuar.
2. Këto forma të demokracisë së brendshme në PD janë të lejueshme deri në momentin kur grupet ose individët që mbrojnë një alternativë të ndryshme nga shumica, nuk fillojnë të veprojnë në bashkëpunim me individë, parti ose organe, që duan ta dëmtojnë PD-në.

Neni 55

1. PD mbështet respektimin e shkallës së domosdoshme të hierarkisë partiake.
2. Vendimet e organeve qendrore të PD-së janë të detyrueshme për kuvendet e degëve, kuvendet e nëndegëve dhe organët udhëheqëse të PD-së, sipas hierarkisë të përcaktuar në këtë Statut.

Neni 56

Çdo njësi e PD-së vepron brenda kompetencave të saj, duke pasur parasysh interesat dhe politikën e përgjithshme të PD-së, si dhe vendimet e udhëzimet e organeve më të larta.

Neni 57

1. Për ruajtjen e funksionimit statusor të PD-së dhe për mbrojtjen e tij mund të zbatohen masa disiplinore partiake. Masat disiplinore janë: vërejtja, para përjashtimi dhe përjashtimi.
2. Çështjen e përjashtimit të anëtarit të PD-së e shqyrton, me nismën e vet dega ose kjo mund të bëhet me sugjerimin e organeve më të larta.
3. Vendimi për përjashtimin e një anëtari konsiderohet i miratuar atëherë kur atë e ka miratuar Kryesia e Degës.
4. I ndëshkuari për masën e shqiptuar disiplinore mund të bëjë ankesë brenda 15 ditëve pranë Gjykatës së Nderit.
5. Vendimi i Gjykatës së Nderit është përfundimtar.

Neni 58

1. Anëtarët e PD-së, që kanë detyra drejtuese, mund të pezullohen e të shkarkohen nga detyrat e tyre, për shkelje të disiplinës.
2. Kryetarin dhe anëtarin e kryesisë së nëndegës mund ta pezullojë kryesia e degës deri në mbledhjen e radhës së Kryesisë së nëndegës, në të cilën do të shqyrtohet shkarkimi.
3. Kryetarin dhe anëtarin e Kryesisë së degës mund ta pezullojë Kryesia e PD-së, deri në

mbledhjen e Kuvendit të degës, në të cilën do të shqyrtohet shkarkimi i tij, që duhet të mbahet brenda 15 ditëve kalendarikë.

4. Në rast se Kuvendi i degës nuk mblidhet brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni, Kryesia qendrore merr vendim për shkarkimin e Kryetarit të degës ose anëtarit të Kryesisë dhe nisë procedurat për kuvend të jashtëzakonshëm të degës.

5. Për Kryetarin mund të merret si masë disiplinore vetëm shkarkimi në Kuvendin e jashtëzakonshëm.

6. Propozimin për të marrë një vendim të tillë në Këshillin Drejtues duhet ta bëjë Kryesia e PD-së, kur për këtë kanë votuar 3/4 e anëtarëve të saj.

7. Vendimi për thirrjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm duhet të merret nga Këshilli Drejtues, me 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij.

8. Vetë Kryesia mund të marrë në shqyrtim këtë çështje kur këtë e kërkon shumica e thjeshtë anëtarëve të saj, ose kur kërkesa mbështetet nga më shumë se gjysma e degëve të PD-së, që kanë mbajtur Kuvend të jashtëzakonshëm të degës për këtë qëllim dhe të cilët për këtë e kanë informuar Kryesinë e PD-së me procesverbal zyrtar nga mbledhja e Kuvendit për të cilin paraprakisht është informuar Kryesia e PD-së.

9. Kryesia e PD-së formon komisionin verifikues i cili duhet domosdoshmerisht me qene pjes e ati takimi te degeve per te verifikuar mandatet e antarëve dhe prezencen e tyre.

10. Për anëtarin, sekretarin e përgjithshëm dhe nënkryetarin e Kryesisë së PD-së merret vetëm masa disiplinore: shkarkim nga pozita apo përjashtim nga Këshilli Drejtues i PD-së.

11. Propozimin për një masë të tillë e bën Kryetari; vendimi për ta paraqitur propozimin në Këshillin Drejtues duhet të merret me 1/2 e votave të anëtarëve të pranishëm të Kryesisë.

Këshilli Drejtues mund ta marrë vendimin për shkarkimin e anëtarit të Kryesisë, kur për këta kanë votuar 1/2 e numrit të anëtarëve të pranishëm të Këshillit Drejtues.

12. Për të gjithë të pezulluarit apo të shkarkuarit nga detyra, Kryesia e degës ku ata bëjnë pjesë ka të drejtë që me nismën e vet, ta marrë në shqyrtim rastin dhe të shprehet deri për përjashtim nga PD-ja në qoftë se vërtetohet një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 14 të këtij Statuti.

13. Për të gjitha rastet e marrjes së masave disiplinore mbahen shënimet në regjistrat përkatës, që ruhen pranë kryesive të degëve ose pranë Kryesisë së PD-së.

Këshilli Drejtues i PD-së me 1/2 e anëtarëve të pranishëm merr ose nuk merr vendim në pajtim me vendimin e Kryesisë së PD-së.

Kapitulli i VII

Funksionimi dhe dokumentacioni i PD-së

Neni 59

1. Të gjitha njësitë e PD-së organizojnë mbledhje të rregullta periodike dhe mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilat diskutohen probleme politike dhe merren vendime.
2. Mbledhjet mund të bëhen me rend dite të vendosur paraprakisht ose edhe pa rend dite të përcaktuar, si dhe me ose pa raporte të përgatitura më parë.
2. Kur është vendosur se është e domosdoshme të përgatiten materiale paraprake, drejtuesit marrin masat e duhura.
3. Diskutimet në mbledhje janë të lira, por pjesëmarrësit mund të përcaktojnë rregulla të përshtatshme për mbarëvajtjen e debatit.
4. Kritika është e lirë brenda normave të mirësjelljes dhe të disiplinës.

Procesverbali i mbledhjeve të PD-së

Neni 60

1. Zhvillimet e mbledhjeve pasqyrohen në procesverbale përkatëse që duhet të jenë të qarta dhe të përmbajnë emrat e pjesëmarrësve në diskutim si dhe konkluzionet dhe vendimet, duke mos përfshirë çdo gjë që thuhet në mbledhje.
2. Çdo anëtar i Kryesisë ka të drejtë të saktësojë thëniet e tij para se të mbyllet procesverbali; procesverbali nënshkruhet nga personi i ngarkuar për këtë punë.
3. Procesverbalet ruhen për një afat 5 vjeçar.
4. Për çdo mbledhje të Kryesisë ose Kuvendit të degës me procesverbal të veçantë duhet të informohet Kryesia e PD-së.

Neni 61

1. Çdo degë bën listën e anëtarëve të saj dhe plotëson formularët sipas modelit të miratuar nga Kryesia e PD-së. Formularët depozitohen në Kryesinë e degës dhe Administratën Qendrore
2. Lista e formularëve me anëtarët e PD-së ruhet në arkivin e Kryesisë së PD-së.

Neni 62

Kryesia e PD-së mban regjistra të rregullt të gjithë të zgjedhurve në forumet qendrore të PD-së. Kryesitë e Degëve mbajnë evidencën përkatëse për të zgjedhurit në degë.

Neni 63

1. Çdo anëtarë i PD-së pajiset me kartel identiteti politik.
2. Kartela e anëtarit duhet të ketë në syprinë emblemën e PD-së, ndërsa brenda saj: emrin, emrin e prindit dhe mbiemrin, vendlindjen, vendin e banimit, moshën dhe datën e pranimin në PD.

Kapitulli VIII

Të hyrat dhe pasuritë e PD-së

Neni 64

1. PD-ja i siguron mjetet financiare dhe pasurore për të zhvilluar veprimtarinë e saj nga burimet ligjore, si vijon:

1.1. Të hyrat nga detyrimet e anëtarësisë që vendosen në përputhje me mundësitë e kategorive të ndryshme të anëtarëve, në vend dhe jashtë tij, nga Kryesia e PD-së.

1.2. Të hyrat që i takojnë nga buxheti i shtetit;

1.3. Dhuratat nga organizmat partiake, shoqërore, persona juridiko e privatë, brenda e jashtë vendit, në pajtim me ligjin.

Neni 65

PD-ja nuk pranon dhurata ose ndihmë financiare e materiale nga shoqata, apo persona fizikë e juridikë, të cilët janë në kundërshtim me programin dhe parimet e saja.

Neni 66

1. Dhuratat që i jepen PD-së përdoren vetëm për veprimtari të PD-së dhe në asnjë rast për nevoja personale, me përjashtim të rasteve kur, me vendim të posaçëm, u jepet ndihmë anëtarëve të PD-së në rast të fatkeqësive.

2. Vendimi përkatës mund të merret nga Kryesia e PD-së.

Neni 67

1. Të ardhurat e PD-së administrohen sipas rregullores që e miraton Kryesia e PD-së.

2. Zbatues i planit financiar është Kryetari ose Sekretari i Përgjithshëm i autorizuar nga ana e Kryetarit, në pajtim me ligjin, ose anëtari i Kryesisë së PD-së i autorizuar nga Kryetari.

3. Mbikëqyrës për çështjet financiare në PD është Kryetari i Komisionit për Kontrollimin e Veprimtarisë Financiare, që për Kryesinë e Partisë përgatitë raport të veçantë dy herë në vit.

Neni 68

Planifikimin e përgjithshëm të të ardhurave e të shpenzimeve si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre e miraton Kryesia e PD-së.

Kapitulli IX

Dispozita përfundimtare

Neni 69

1. Kur për shkaqe statutove lirohet vendi në Kryesinë e degës apo Kryesin e PD-së, ai plotësohet me kandidat tjetër të miratuar nga Kryesia e degës apo Kryesia e PD-së, gjë për të cilën mund të përdoret edhe metoda e kooptimit.
2. Për ndryshimet e bëra njoftohet Kryesia e PD-së ose Këshilli Drejtues.

Neni 70

1. PD nuk krijon mekanizma të tjerë, gjysmë të pavarur dhe jo statutor.
2. PD mund të themelojë medime elektronike dhe të shkruara, në përputhje me ligjin.
3. Organet e marketingut dhe shtypi i PD-së i përgjigjen Kryesisë së PD-së dhe funksionojnë në pajtim me ligjet në fuqi, duke përfshirë shpenzimet dhe përfitimet financiare.

Neni 71

Ky Statut është dokument për përdorim të brendshëm partiak dhe njëkohësisht është në dispozicion të opinionit të gjerë.

Neni 72

1. PD-ja është e hapur në gjithë veprimtarinë e saj dhe nuk zhvillon asnjë veprimtari të fshehtë e të ndaluar nga ligjeve vendore dhe ato ndërkombëtare.
2. Anëtarët e saj duhet të jenë të kujdesshëm për të mos bërë publike veprimet e taktikat e veprimtarisë politike të PD-së, për aq kohë sa mendohet se ato mund të mbeten çështje e saj e brendshme dhe derisa nuk janë shpallur si qëndrime zyrtare.

Neni 73

1. Normat e vendosura në këtë Statut duhet të njihen e të zbatohen me korrektësi nga të gjithëanëtarët e PD-së.
2. Ato mund të përsosen me rrugë demokratike bazuara me sugjerimet e anëtarëve të instancave tëndryshme të PD-së, duke filluar nga Kuvendi i PD-së.
3. Në periudhën midis dy kuvendeve, në rast të mos funksionimit të Komisionit për mbikëqyrjen e statutit, Kryetari, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e PD-së bëjnë interpretime të normave statutove kur dalin probleme gjatë zbatimit të tyre, këto interpretime janë përfundimtare dhe të obligueshme për zbatim.

Neni 74

1. Procedura për shpërbërjen e PD-së mund të fillojë me propozimin e më së paku 2/3 të anëtarëve të Kryesisë së PD-së dhe me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kryesisë i procedohet Këshillit Drejtues.

2. Këshilli Drejtues e shqyrton propozimin për shpërbërjen e PD-së dhe me 2/3 e anëtarëve të përgjithshëm merr vendim rekomandimin e Kuvendit të jashtëzakonshëm, për shpërbërjen e Partisë.
3. Kuvendi i jashtëzakonshëm merr vendim për shpërbërjen e PD-së me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit në mënyrë të thjeshtë.
4. Me vendimin mbi shpërbërjen e PD-së vendoset njëherësh edhe për pasurinë e PD-së dhe shlyerjen e borxheve eventuale.
5. Pasuria e PD-së mund t'u dedikohet enteve që kujdesen për persona me aftësi të kufizuara apo institucioneve që merren me veprimtari humanitare.
6. PD-ja mund të shpërbëhet vetëm atëherë kur nuk ka obligime ndaj institucioneve kompetente, personave juridik dhe atyre fizikë.

Neni 75

1. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen sipas procedurës për nxjerrjen e tij.
2. Për këtë qëllim, Kryesia e PD-së formon komisionin pesë (5) anëtarësh.
3. Kryesia e PD-së shqyrton propozimin e komisionit dhe merr vendim përkitazi me këtë çështje me 2/3 e anëtarëve të pranishëm.
4. Propozimi i miratuar i paraqitet Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues vendos me 2/3 e anëtarëve të pranishëm dhe e përcakton propozimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit për Kuvend.
5. Propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit mund të paraqiten edhe në ditën e mbajtjes së Kuvendit.
6. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi.

Neni 76

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet statuti i PD-së, i datës 07.06.2015, si dhe të gjitha dispozitat e çdo akti tjetër normativ që kanë fuqi të njëjtë në PD dhe që janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 80

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i PD-së

Kryesuesi i Kuvendit të Partisë së Drejtësisë



Eroll Venhari